

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Trepça SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **Nr.prok. 12997 12998-26-3727-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me motora dhe pjesë rezervë për makina nëntoksore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

”LEXALKO SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova,

(Adresa)

Lipjan,

(Vendi)

+383 48770333

(Numri Telefonit)

14000

(Kodi postar)

n/a

(Numri i Faks-it)

Hetem Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

sales.ks@lexalko.com

(Adresa elektronike)

HetemImeri123

11.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë 19.05.2026
- Afati i fundit për dorëzim të tenderit 30.06.2026 në ora 13.00H
- Njoftimi i AK .-B58 Njoftimi për dhenje të kontratës 28.02.2026
- Kriteret e Dhenies së tenderit: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kompania e jone me 31.07.2026 ka bere Kerkese per rishqyrtim duke i justifikuar te gjitha pretendimet tona ankimore mirepo AK nuk i merr per baze dhe me daten 03.08.2026 pranojme Vendimin si vijon:

Kërkesa për Rishqyrtim refuzohet si e pabazuar, pasi të gjitha kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë plotësuar nga OE, i propozuar për kontratë. Pershkrimet e produkteve të ofertuara janë të nenvizuara dhe janë të gjitha bazë katalogut të ofruar. Në dosjen e tenderit ndër tjera është kërkuar: Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni. Dëshmi se PRIDA është përfaqësues i autorizuar ka bashkëngjit në certifikat të cilin mund të shihet edhe në web faqen e deutz si përfaqësues i autorizuar. Ne si AK qëndrojmë pranë njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe kërkesa e juaj për rishqyrtim refuzohet

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Shkelja e nenit 1-Qellimi i LPP-se te amandamentuar
- Shkelja e nenin 7- Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të amandamentuar
- Shkelja e nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tenderëve te LPP te amandamentuar

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shoqëria "LEXALKO" Shpk me seli në Lipjan (me tej: Kerkuesi), brenda afatit ligjor te paraparë më dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, brenda afatit të lënë për Ankesë paraqet këtë:

ANKESË

per shkak te:

- Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike
- Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale

Me te cilen Operatori Ekonomik LEXALKO SH.P.K., në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, paraqet këtë Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues Trepça Sh.A., të datës 03.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur, si dhe kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës të datës 28.07.2026, me të cilin është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik ERVING SHPK.

Ankuesi konsideron se vendimi i AK është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, pasi bazohet në një konstatim të gabuar të gjendjes faktike, në zbatim të gabuar të kushteve të Dosjes së Tenderit dhe nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm lidhur me pretendimet konkrete të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Pretendimet e paraqitura nga ankuesi nuk janë trajtuar individualisht, ndërsa Autoriteti Kontraktues është kufizuar në konstatime të përgjithshme se "të gjitha kriteret janë përmbushur", **pa shpjeguar mbi çfarë provash dhe mbi çfarë baze juridike ka arritur në këtë përfundim.**

Për më tepër, pas dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim, ankuesi ka siguruar një dokument të ri zyrtar nga **DEUTZ AG**, i cili përbën provë të re relevante për vlerësimin e kriterit të autorizimit dhe i cili objektivisht nuk ka mundur të paraqitet gjatë fazës së rishqyrtimit pranë Autoritetit Kontraktues. (SHTOJCE DESHMIA)

Për këto arsye, ankuesi kërkon nga Paneli Shqyrtues që të shqyrtojë në mënyrë të plotë ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe përputhshmërinë e dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

1. VENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES NUK PERMBAN ARSYETIM TE MJAFTUESHEM

Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës **03.08.2026** nuk përmbush standardin e një vendimi administrativ të arsyetuar, pasi nuk trajton në mënyrë konkrete pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Në Kërkesën për Rishqyrtim, ankuesi ka ngritur një numër të konsiderueshëm pretendimesh faktike dhe juridike, të mbështetura në dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Ndër të tjera, ishte argumentuar se dokumenti "**Official Agreement Letter**" nuk përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit për autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar, se dokumenti nuk përmban elementet minimale identifikuese të një autorizimi, se mungon kontrata ose autorizimi ndërmjet PRIDA Machinery dhe DEUTZ, si dhe katalogu i dorëzuar nuk përmbush kërkesën për nënvizimin e produkteve të ofruara.

Megjithatë, në vend që t'i analizojë këto pretendime një nga një, Autoriteti Kontraktues është kufizuar në deklaratime të përgjithshme, si:

"Kërkesa për Rishqyrtim refuzohet si e pabazuar, pasi të gjitha kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë plotësuar nga OE i propozuar për kontratë."

Një konstatim i tillë nuk përbën arsyetim administrativ, pasi nuk shpjegon:

- mbi cilat prova është mbështetur Autoriteti Kontraktues;
- si është vlerësuar secili pretendim i ankuesit;
- përse dokumenti "**Official Agreement Letter**" është konsideruar autorizim i vlefshëm;
- nëse është verifikuar dokumenti që vetë "**Official Agreement Letter**" e përmend si bazë të marrëdhënies ndërmjet PRIDA dhe DEUTZ;
- mbi çfarë baze është konstatuar se katalogu përmban produktet e nënvizuara.

Në të njëjtën mënyrë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur

me mangësitë konkrete të dokumentit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, **si mungesa e datës, mungesa e numrit të referencës, mungesa e identifikimit të personit përgjegjës dhe mungesa e një lidhjeje të drejtpërdrejtë me procedurën konkrete të prokurimit.** Kërkesa decidive e AK ka qene: " Në dosjen e tenderit ndër tjera është kërkuar: **Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni**" OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prur Autorizim nga prodhuesi dhe as nga dileri pasi domuneti i ofruar është "Official Agreement Letter" / "Letër Zyrtare e Marrëveshjes" nuk ka të beje fare me Autorizim që AK ka kërkuar. Mandej nëse është nga dileri, AK ka kërkuar që të sillet kontrata ose autorizimi në mes dilerit dhe prodhuesit ndersa OE ka sjelle një **"Lista e Distributorëve/Dilerëve të Certifikuar të DEUTZ në Kinë"**. Dokument i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk të beje fare me kërkesen AK. Dokumenti i ofruar është listë e distributorëve të certifikuar për DEUTZ në tregun e KINES. Kjo nuk ka lidhje fare për rastin e këtij projekti, deshmia të cilin e ka ofruar OE është një distributor për tregun e Kines nuk bëhet fjalë për tregun e Kosovës

Mandej një vendim që nuk analizon pretendimet konkrete të palës ankuese nuk i mundëson as operatorit ekonomik dhe as Panelit Shqyrtues të verifikojnë ligjshmërinë e përfundimeve të Autoritetit Kontraktues.

Për më tepër, një arsyetim i tillë nuk është në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe zhvillimit të një procedure të drejtë dhe objektive të prokurimit publik, të garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik.

Nga përmbajtja e vendimit rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer një analizë të plotë faktike dhe juridike të pretendimeve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim. Për rrjedhojë, vendimi nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm për të mbështetur ligjshmërinë e rekomandimit për dhënien e kontratës operatorit ekonomik të rekomanduar.

2. VENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES NUK PERMBAN ARSYETIM TE MJAFTUESHEM

Autoriteti Kontraktues, në nenin 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit, ka përcaktuar si kriter të detyrueshëm të kualifikimit: **"OE furnizuesi i prodhimeve duhet të ketë autorizim nga prodhuesi për shitjen e produkteve."** Ndërsa si dëshmi është kërkuar: **"Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni."**

Ky kriter është formuluar në mënyrë të qartë dhe nuk lë hapësirë për interpretim. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar paraqitjen e një dokumenti të caktuar dhe ka përcaktuar edhe dokumentin shtesë që duhet të paraqitet në rast se autorizimi

lëshohet nga një diler i autorizuar.

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar rezulton se, në vend të autorizimit të kërkuar nga Dosja e Tenderit, është dorëzuar një dokument i titulluar **"Official Agreement Letter"**.*

Nga përmbajtja e këtij dokumenti nuk rezulton se ai përmban një deklaram të qartë të prodhuesit ose të dilerit të autorizuar, me të cilin OE ERVING SHPK autorizohet për shitjen e produkteve objekt të kësaj procedure të prokurimit. Në veçanti, dokumenti nuk përmban formulime karakteristike të një autorizimi, si:

- *"We authorize";*
- *"Authorized Distributor";*
- *"Authorized Reseller";*
- *"Authorized to sell";*
- *"Authorized to participate in this procurement procedure".*

Përmbajtja e dokumentit flet për ekzistencën e një marrëdhënieje bashkëpunimi ndërmjet PRIDA Machinery dhe OE ERVING SHPK, por nuk përmban një deklaram të qartë që plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit për autorizimin e shitjes së produkteve që janë objekt i kësaj kontrate.

*Për më tepër, vetë titulli **"Official Agreement Letter"** tregon se dokumenti paraqitet si një marrëveshje ("Agreement") dhe jo si një autorizim ("Authorization"). Këto dy dokumente kanë natyrë juridike të ndryshme dhe nuk mund të konsiderohen automatikisht ekuivalente pa një analizë të përmbajtjes së tyre.*

Në vendimin e datës 03.08.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim se për çfarë arsye e ka konsideruar këtë dokument si autorizim në kuptimin e kërkesës së Dosjes së Tenderit. Vendimi kufizohet vetëm në konstatimin se kriteret janë përmbushur, pa analizuar përmbajtjen e dokumentit dhe pa iu përgjigjur argumenteve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Në këto rrethana, ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka pranuar një dokument pa arsyetuar nëse ai përmbush kërkesën e përcaktuar nga vetë Dosja e Tenderit, duke vepruar në kundërshtim me parimin e vlerësimit objektiv të ofertave dhe me detyrimin për të zbatuar kriteret e kualifikimit në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Nga analiza e mësipërme rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të përcaktuar në nenin 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit në mënyrën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim faktik dhe juridik mbi bazën e të cilit ka

arritur në përfundimin se dokumenti "**Official Agreement Letter**" përbën autorizim të vlefshëm për qëllimet e kësaj procedure të prokurimit.

3. ANALIZA E DOKUMENTIT "OFFICIAL AGREEMENT LETTER"

Përveç faktit se dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik i rekomanduar nuk përmban një deklaram të qartë autorizues, ai paraqet edhe një sërë mangësish objektive që Autoriteti Kontraktues nuk i ka analizuar dhe as nuk i ka arsyetuar në vendimin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentit rezulton se:

- mungon data e lëshimit të dokumentit;
- mungon numri i referencës ose ndonjë element tjetër identifikues;
- mungon emri dhe mbiemri i personit që pretendohet ta ketë lëshuar dokumentin;
- mungon funksioni ose pozita zyrtare e këtij personi;
- mungon një nënshkrim i identifikueshëm i përfaqësuesit të subjektit që pretendohet se e ka lëshuar dokumentin;
- mungon afati i vlefshmërisë së dokumentit;
- dokumenti nuk përmban asnjë referencë ndaj Autoritetit Kontraktues, numrit të prokurimit apo procedurës konkrete të prokurimit.

Në praktikën e zakonshme të marrëdhënieve tregtare, dokumentet që përdoren për të provuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit përmbajnë elemente identifikuese që mundësojnë verifikimin e origjinës, autenticitetit dhe vlefshmërisë së tyre. Në rastin konkret, këto elemente mungojnë, ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmban asnjë analizë lidhur me këtë çështje.

Kompania e jone ka ngritur gjithashtu shqetësime lidhur me paraqitjen grafike të dokumentit, veçanërisht në pjesën e sipërme (header), ku logoja **PRIDA** dhe elemente të tjera vizuale krijojnë dyshime të arsyeshme nëse dokumenti është përgatitur në mënyrë të njëtrajtshme. **Këto rrethana nuk përbëjnë, në vetvete, provë se dokumenti është manipuluar, por përbëjnë arsye të mjaftueshme që Autoriteti Kontraktues të kryente një verifikim të autenticitetit të tij ose të kërkonte konfirmim nga subjekti që pretendohet se e ka lëshuar.**

Në vendimin e datës 03.08.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar asnjë nga këto pretendime. Nuk rezulton se është bërë ndonjë verifikim i dokumentit dhe nuk është dhënë asnjë arsyetim pse mangësitë e evidentuara nuk janë konsideruar relevante për vlerësimin e përmbushjes së kriterit të kualifikimit.

Një element me rëndësi të veçantë është se vetë dokumenti "**Official Agreement Letter**" përmban deklarin:

"Part of this agreement is also the authorization or contract that Prida Machinery has with DEUTZ."

Prandaj vete formulimi I ketij dokumenti pranon se ekziston një autorizim ose kontratë ndërmjet **PRIDA Machinery** dhe **DEUTZ**.

Ndërkohë, Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht se: "**Nëse autorizimi është nga dileri, atëherë si dëshmi të sillet kontrata ose autorizimi mes dilerit dhe prodhuesit.**"

Pavarësisht kësaj kërkesë të qartë, Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij nuk ka sqaruar nëse kjo kontratë ose ky autorizim është dorëzuar, është verifikuar dhe është marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të ofertës.

Në vend të kësaj, Autoriteti Kontraktues është kufizuar të deklarojë se PRIDA është përfaqësues i autorizuar dhe se kjo mund të shihet në faqen zyrtare të DEUTZ.

Megjithatë, ky konstatim **nuk i përgjigjet pretendimit të ankuesit**, sepse çështja nuk është nëse PRIDA është distributor i DEUTZ, por nëse është dorëzuar dokumenti që Dosja e Tenderit e ka kërkuar si dëshmi të detyrueshme kur autorizimi buron nga një diler.

Për rrjedhojë, përgjigjja e Autoritetit Kontraktues nuk adreson thelbin e pretendimit dhe nuk sqaron nëse kriteri është përmbushur në mënyrën e kërkuar nga vetë Dosja e Tenderit.

Nga analiza e dokumentit "**Official Agreement Letter**" rezulton se ai paraqet mangësi objektive dhe nuk përmban elemente të rëndësishme identifikuese që normalisht priten nga një dokument i përdorur për të provuar përmbushjen e një kriteri kualifikues. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këto mangësi dhe nuk ka sqaruar nëse është dorëzuar dhe verifikuar kontrata ose autorizimi ndërmjet PRIDA Machinery dhe DEUTZ, ndonëse kjo ishte kërkuar shprehimisht nga Dosja e Tenderit.

4. PROVA E RE APO ARGUMENTI I RI I SIGURUAR NGA PRODHUESI DEUTZ AG

Pas dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, ankuesi ka pranuar një përgjigje zyrtare nga **DEUTZ AG**, e datës **31.07.2026**, e cila është pranuar nga ankuesi ne **ora 15.17h** pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim dhe, për rrjedhojë, objektivisht nuk ka mundur të jetë pjesë e procedurës së zhvilluar pranë Autoritetit Kontraktues.

Deshmia e pranimit te shkreses data 31.07.2026 ne ora 15.17 h

Von: Upmann, Andreas <andreas.upmann@deutz.com>
Gesendet: Freitag, 31. Juli 2026 15:17
An: Sternberg, Kaspar <Kaspar.Sternberg@deutz.com>
Betreff: zur Unterschrift

DEUTZ Aktiengesellschaft
Vorsitzender des Aufsichtsrats/Chairman of the Supervisory Board: Dr. Dietmar Voggenreiter
Vorstand/Board of Management: Dr. Sebastian C. Schulte (Vorsitz/Chairman), Katharina Krüger, Oliver Neu
Sitz und Registergericht/Domicile and Register Court: Köln/Cologne
Nr. des Handelsregisters/Commercial Register No.: 42 HRB 281

Diese E-Mail enthält vertrauliche und möglicherweise rechtlich geschützte Informationen.
Informationen zur Verarbeitung Ihrer Daten und dem Datenschutz bei DEUTZ finden sie unter dem folgenden Link:
<https://www.deutz.com/en/company/privacy-policy/faq/>

Wenn Sie nicht der richtige Adressat sind oder diese E-Mail irrtümlich erhalten haben, informieren Sie bitte sofort den Absender und vernichten Sie diese E-Mail.
Das unerlaubte Kopieren sowie die unbefugte Weitergabe dieser E-Mail ist nicht gestattet.

This e-mail contains confidential and may well also contain privileged information.

To learn more about data protection and the processing of your personal data at DEUTZ, click here:
<https://www.deutz.com/en/company/privacy-policy/faq/>

If you are not the intended recipient (or have received this e-mail in error) please notify the sender immediately and destroy this e-mail.
Any unauthorized copying, disclosure or distribution of the material in this e-mail is strictly forbidden.

[Message clipped] [View entire message](#)

One attachment • Scanned by Gmail  Add to Drive



Deshmia e dorezimit te Kerkeses per Rishqyrtim data 31.07.2026 ora 14.29h:

Shqip ▾



ilir rexhepi, LEXALCO SH.P.K. ▾

Kërkesat për rishqyrtim

Përshkrimi	Kodi intern i procedurës	Emërtimi i procedurës	Statusi i procedurës	Data e dërgimit të kërkesës	Statusi i kërkesës	Afati i fundit për c
Kërkesa per Rishqyrtim	12997 12998-26-3727-1-1	Furnizim me motora dhe pjesë rezervë për malina e shtetshme	Në vlerësim	31.07.2026 14:29	Përgjigjem	

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE i rekomanduar për kontratë, parashtuesi ka siguruar një dokument shtesë të lëshuar nga vetë Shijiazhuang PRIDA Machinery Co., Ltd., me titull “STATEMENT OF COMMITMENT”, të datës 08.2026.

Në këtë dokument, PRIDA deklaron se është “an authorized Class A distributor of DEUTZ in China” dhe se shet DEUTZ original spare parts dhe DEUTZ original engine assemblies në Kinë.

Ky dokument konfirmon statusin e PRIDA-s si distributor i autorizuar i DEUTZ në Kinë, por nuk përmban asnjë deklaram apo autorizim të drejtpërdrejtë për ERVING SHPK, nuk e identifikon këtë operator si dealer/distributor të autorizuar dhe nuk dëshmon marrëdhënien konkrete të autorizimit PRIDA–ERVING për shitjen e produkteve objekt të kësaj procedure.

Për më tepër, deklarimi i PRIDA-s i referohet shprehimisht shitjes së produkteve “in China”, çka e bën edhe më të nevojshme që Autoriteti Kontraktues të verifikojë në mënyrë të dokumentuar zinxhirin e autorizimit DEUTZ → PRIDA → ERVING SHPK, në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit.(SHTOJCE DOK-PRIDA)

Në këtë përgjigje zyrtare, DEUTZ AG konfirmon se:

- **PRIDA Machinery** është distributor lokal i autorizuar vetëm për territorin e Republikës Popullore të Kinës;

- çdo shitje jashtë këtij territori duhet të realizohet vetëm në përputhje me autorizimet dhe politikat e DEUTZ AG;
- për procedurat jashtë territorit për të cilin është autorizuar distributori, kompetenca për autorizime dhe furnizime nuk buron automatikisht nga statusi i distributorit lokal.

Edhe pse nuk e kishim në dispozicion këtë dokument në momentin e paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, përmbajtja e tij mbështet nevojën për një verifikim më të thelluar të dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar dhe të marrëdhënies juridike ndërmjet **DEUTZ AG, PRIDA Machinery dhe ERVING SHPK**.

Me paraqitjen e këtij dokumenti vertetuan pretendimet tona se OE ekonomik I rekomanduar për kontratë Autorizimin nuk e ka ashtu siç kishte kekuar AK dhe mendojme që Autorizimi- "**Official Agreement Letter**" është I punuar.

Në këtë kontekst, nuk pretendojme që kjo letër, në vetvete, provon pavlefshmërinë e dokumentit "Official Agreement Letter". Megjithatë, ajo krijon një bazë objektive që Paneli Shqyrtues të kërkojë verifikimin e plotë të dokumentacionit mbi të cilin është mbështetur Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertës.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pranuar se kriteri është përmbushur mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga një diler, atëherë është e domosdoshme të verifikohet nëse ky diler ka pasur kompetencën për të lëshuar një autorizim të tillë për këtë procedurë konkrete dhe nëse janë dorëzuar të gjitha dokumentet që Dosja e Tenderit i ka kërkuar si dëshmi.

Përgjigjja zyrtare e DEUTZ AG përbën një provë të re, të siguruar pas fazës së rishqyrtimit, e cila lidhet drejtpërdrejt me pretendimet e ankuesit dhe me mënyrën se si është vlerësuar kriteri i autorizimit. Për këtë arsye, ankuesi kërkon që Paneli Shqyrtues ta marrë këtë provë në konsideratë

5. MOSPERMBUSHJA E KERKESES SE DOSJES SE TENDERIT LIDHUR ME KATALOGET E PRODUKTEVE

Në Aneksin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar si dëshmi:

"2.OE duhet të ofroj katalogun për pjesët e ofruara dhe të nënvizoj në katalog secilin pozicionin e ofruar dhe pjesët (elementet përciellse).."

Kjo kërkesë është vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe ka karakter obligativ për të gjithë operatorët ekonomikë. Qëllimi i saj është të mundësojë identifikimin e saktë të produkteve të ofruara dhe të lehtësojë verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara.

Nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar, ankuesi nuk ka arritur të identifikojë produktet që pretendohet se janë nënvizuar në përputhje me këtë kërkesë që janë identifikuar me ndonjë numer identifikues **(SHTOJCE Katalogu të cilin na ka dorezuar AK)**

Në vendimin e datës 03.08.2026, Autoriteti Kontraktues është shprehur vetëm se: "Përshkrimet e produkteve të ofertuara janë të nënvizuara dhe janë të gjitha bazë katalogut të ofruar." **Nese ka ndonje katalog tjeter ateherë AK nuk na ka dorezuar fare, mirepo ne shtojce do ta gjeni katalogun e dorezuar nga OE i rekomanduar me kontrate)**

Megjithatë, ky konstatim nuk shoqërohet me asnjë arsyetim konkret. Vendimi nuk tregon:

- në cilat faqe të katalogut ndodhen nënvizimet;
- cilat produkte janë identifikuar si të nënvizuara;
- në çfarë mënyre është verifikuar përputhshmëria e tyre me artikujt e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Ankuesi ka analizuar katalogun e dorëzuar dhe nuk ka mundur të konstatojë ekzistencën e nënvizimeve që pretendon Autoriteti Kontraktues. Për këtë arsye, mbetet e paqartë mbi çfarë baze faktike është arritur ky përfundim.

Në mungesë të një arsyetimi të tillë, Paneli Shqyrtues nuk mund të verifikojë nëse kërkesa e Dosjes së Tenderit është përmbushur realisht apo nëse Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm, pa analizuar dokumentacionin në mënyrën e kërkuar.

Nëse gjatë shqyrtimit të Ankesës konstatohet se katalogu nuk përmban nënvizimet e kërkuara, atëherë rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka

përbushur një kërkesë të përcaktuar nga vetë Dosja e Tenderit, e cila duhej të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se produktet janë nënvizuar në katalog nuk është mbështetur me asnjë analizë konkrete në vendimin e datës 03.08.2026. Duke qenë se na si perfaqësues të Ankuesit nuk kemi mundur të identifikojmë nënvizimet e pretenduara në katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar, kërkohet që Paneli Shqyrtues të verifikojë drejtpërdrejt këtë dokument dhe të konstatojë nëse kërkesa e Dosjes së Tenderit është përbushur në mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të kufizohet vetëm në deklarinë se një kërkesë është përbushur. Kur një operator ekonomik konteston me argumente konkrete përbushjen e një kriteri të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të japë një arsyetim të qartë, duke treguar se mbi cilat dokumente dhe mbi cilat pjesë të tyre është mbështetur. Në rastin konkret, një arsyetim i tillë mungon plotësisht.

6. SHKELJET E LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK

Nga mënyra se si është zhvilluar procesi i vlerësimit të ofertave dhe si është vendosur për Kërkesën për Rishqyrtim, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat dhe parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

1. Shkelja e nenit 7 – Barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi

Neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka pranuar dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar pa arsyetuar nëse ai përbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Një qasje e tillë cenon parimin e trajtimit të barabartë, pasi kriteret e kualifikimit duhet të zbatohen njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë.

2. Shkelja e nenit 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 59 obligon Autoritetin Kontraktues që ofertat të vlerësohen në mënyrë objektive dhe vetëm mbi bazën e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Në këtë procedurë nuk rezulton se është bërë një analizë e plotë e dokumenteve të operatorit ekonomik të rekomanduar. Veçanërisht nuk është arsyetuar:

- pse "Official Agreement Letter" është konsideruar autorizim i vlefshëm;
- nëse është dorëzuar kontrata ose autorizimi ndërmjet PRIDA Machinery dhe DEUTZ;
- mbi çfarë baze është konstatuar se katalogu përmban produktet e nënvizuara.

Në mungesë të një analize të tillë nuk mund të konsiderohet se vlerësimi është kryer në mënyrë objektive dhe të dokumentuar.

3. Shkelja e parimit të transparencës

Një nga parimet themelore të prokurimit publik është transparenca e procesit të vlerësimit. Vendimi i datës 03.08.2026 nuk përmban arsyetim për shumicën e pretendimeve të paraqitura, por kufizohet në konstatime të përgjithshme se kriteret janë përmbushur.

Një vendim i tillë nuk i mundëson operatorit ekonomik dhe as Panelit Shqyrtues të kuptojnë mbi çfarë baze faktike dhe juridike janë pranuar dokumentet e operatorit ekonomik të rekomanduar.

4. Konstatimi i gabuar i gjendjes faktike

Konsiderojme se Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar drejt gjendjen faktike, pasi nuk ka analizuar në mënyrë të plotë dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar dhe nuk ka dhënë përgjigje konkrete lidhur me pretendimet e ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Veçanërisht mbeten pa përgjigje çështje me rëndësi vendimtare për ligjshmërinë e procedurës, si:

- vlefshmëria e dokumentit "Official Agreement Letter";
- ekzistenca e kontratës ose autorizimit ndërmjet PRIDA Machinery dhe DEUTZ;
- përmbushja e kërkesës për nënvizimin e produkteve në katalog.

Nga të gjitha rrethanat e paraqitura rezulton se vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk mbështetet në një analizë të plotë të dokumentacionit dhe nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm për të vërtetuar se operatori ekonomik i rekomanduar ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit. Për rrjedhojë, konsiderojme se procedura e vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe se çështja duhet t'i kthehet Autoritetit Kontraktues për rivlerësim.

7. ANALIZA KRAHASUESE E PRETENDIMEVE TONA DHE PERGJIGJEJEVE TE AUTORITETIT KONTRAKTUES

Për të lehtësuar shqyrtimin e kësaj Ankese dhe për të pasqyruar në mënyrë të qartë mënyrën se si janë trajtuar pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, ankuesi paraqet analizën krahasuese në vijim:

Pretendimi i paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim	Përgjigjja e AK në Vendimin e datës 03.08.2026	Vlerësimi i Ankuesit
Dokumenti " Official Agreement Letter " nuk përbën autorizim sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.	AK deklaron vetëm se kriteret janë përmbushur.	Nuk është dhënë asnjë analizë juridike se përse dokumenti konsiderohet autorizim në kuptimin e Dosjes së Tenderit.
Dokumenti nuk përmban datë, numër reference, emër, funksion dhe nënshkrim të identifikueshëm të lëshuesit.	Nuk është trajtuar.	Pretendimi ka mbetur pa përgjigje.
Dokumenti nuk lidhet me procedurën konkrete të prokurimit.	Nuk është trajtuar.	Nuk është dhënë asnjë arsyetim.
Vetë dokumenti përmend ekzistencën e kontratës ose autorizimit ndërmjet PRIDA dhe DEUTZ.	AK deklaron se PRIDA është përfaqësues i autorizuar dhe mund të verifikohet në faqen e DEUTZ.	AK nuk ka sqaruar nëse dokumenti që kërkohej nga Dosja e Tenderit është dorëzuar dhe vlerësuar. Statusi i PRIDA si distributor nuk zëvendëson dokumentin e kërkuar nga Dosja.
Janë ngritur shqetësime lidhur me elementet grafike dhe autenticitetin e dokumentit.	Nuk është trajtuar.	AK nuk ka sqaruar nëse ka bërë ndonjë verifikim të dokumentit pranë lëshuesit.
Katalogu nuk përmban produkte të nënvizuara sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.	AK deklaron se produktet janë të nënvizuara.	Vendimi nuk tregon në cilat faqe ndodhen nënvizimet dhe nuk jep asnjë analizë konkrete që mbështet këtë konstatim.

Nga analiza krahasuese rezulton se shumica e pretendimeve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim nuk janë trajtuar në mënyrë individuale nga Autoriteti Kontraktues. Vendimi i datës 03.08.2026 nuk përmban analizë faktike dhe juridike për secilin pretendim, por kufizohet në konstatime të përgjithshme, të cilat nuk mundësojnë verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit.

Për rrjedhojë, ankuesi konsideron se vendimi nuk përmbush standardin e arsyesimit që kërkohej për një akt administrativ të nxjerrë në një procedurë të prokurimit publik.

8. KERKESA

*Duke u bazuar në nenin 109 dhe dispozitat tjera përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe në faktet dhe provat e paraqitura në këtë Ankesë, **LEXALCO SH.P.K.** i propozon Panelit Shqyrtues që:*

1. Ta aprovojë Ankesën si të bazuar.

2. *Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues Trepça Sh.A., datë 03.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim.*
3. *Ta anulojë Njoftimin për Dhënie të Kontratës, datë 28.07.2026.*
4. *Ta kthejë procedurën e prokurimit në rivlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që të bëjë një vlerësim të ri në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.*
5. *Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të japë arsyetim të plotë, individual dhe të dokumentuar për secilin pretendim dhe për secilin dokument të kontestuar, duke shpjeguar bazën faktike dhe juridike mbi të cilën mbështetet vlerësimi i tij.*
6. *Ta marrë në konsideratë edhe provën e re – shkresën zyrtare të DEUTZ AG – e cila është siguruar pas dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim dhe nuk ka mundur të paraqitet më herët, duke qenë relevante për vlerësimin e pretendimeve të ngritura në këtë Ankesë.*

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i kundërshtuar i Autoritetit Kontraktues i ka shkaktuar dhe vazhdon t'i shkaktojë

Operatorit Ekonomik LEXALKO SH.P.K. dëme materiale, pasi si rezultat i pranimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, përkundër mangësive dhe dyshimeve të ngritura lidhur me autorizimin e paraqitur, LEXALKO SH.P.K. është privuar nga mundësia reale për t'u shpallur fitues dhe për të realizuar kontratën.

Për rrjedhojë, dëmi material konsiston në humbjen e mundësisë për përfitimin e kontratës, fitimit të pritshëm nga realizimi i saj, si dhe shpenzimet e bëra për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në këtë procedurë të prokurimit. Ky dëm vazhdon të ekzistojë përderisa vendimi i kundërshtuar mbetet në fuqi.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.
HetemImeri123